



SHPALLJE

Organizata "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" (IADK), është duke zbatuar projektin **"Trajnimi-profesional dhe mundësitë për gjenerimin e të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës"**, periudha e zbatimit të projektit korrik 2019 dhjetor 2020 i përkrahur nga Donatori CFD nga Zvicra. Projekti do të përfshijë komunat: Lipjan, Shtime, Vushtri, Mitrovicë dhe Zubin Potok.

Një prej objektivave të projektit është rritja e mundësive për punësim për të rinjtë nëpërmjet punës praktike dhe trajnimit profesional për studentët. Në kuadër të këtij projekti janë paraparë edhe aktivitetet, siç janë: **Trajnimet për punë praktike dhe sistemimi në punë praktike**. Këto aktivitete do të zbatohen në bashkëpunim me Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin Filozofik-Departamenti i Sociologjisë.

Ftohen studentët nga Fakulteti Filozofik-Departamenti i Sociologjisë, që të aplikojnë për angazhimin në praktika të ndryshme që përshtaten me profesionin e tyre. Numri i studentëve në këtë punë praktikë do të jetë gjithsej 10 (3 nga Fakulteti Filozofik - Departamenti i Sociologjisë) për periudhën 2019-2020.

Fillimisht, studentët e përzgjedhur do të vijojnë trajnime 5 ditore në Qendrën Edukuese të Fermerëve-IADK, Sfaracak i Ulët, komuna Vushtri, trajnimet do të fillojnë në fundin e muajit gusht 2019. Shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimit do të kompensohen nga projekti.

Pas përfundimit të trajnimeve, ky grup do të kryej punë praktike 3 mujore në IADK, në kompani, institucione dhe organizata të ndryshme, ndërsa kandidatet do të kenë një kompensim simbolik, për të mbuluar shpenzimet e ushqimit, të komunikimit dhe të udhëtimit në baza të rregullta mujore. Puna praktike do të bëhet në periudhën gusht 2019 deri në tetor 2020 varësisht nga kërkesat e kandidatëve.

Kandidatët e përzgjedhur duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara me projekt.


KRITERET QË DUHET PLOTËSUAR KANDIDATËT JANË :

- Studentët nga Fakulteti Filozofik-Departamenti Sociologji, që janë në vitin e fundit të studimeve ose kanë përfunduar studimet dhe që janë të pa punë.
- Studentët të interesuar për praktikë duhet të jenë nga komunat përkatëse: Lipjan, Shtime, Vushtri, Mitrovicë dhe Zubin Potok.
- Studentët që shprehin gatishmëri/përkushtim për pjesëmarrje në trajnime dhe në punën praktike në kompani/agrobiznese, institucione dhe organizata tjera duhet të jenë të rregullt në trajnime dhe në punë.
- Përparësi kanë antarët e familjeve të cenuara.

Aplikacioni mund të merren në **zyrat e IADK-së**, në adresë fshati Sfaracak i Ulët, Nr.11, Vushtri ose online në faqet e internetit: www.iadk.org dhe E-mail hafize-veseli@hotmail.com

Aplikacioni mund të dorëzohet në **zyrat e IADK-së** ose përmes emali: hafize-veseli@hotmail.com, info@iadk.org
Për informata shtese mund të kontaktoni në +383 49 467 531 .

Shpallja për aplikim është e hapur nga data 06.08.2019 deri më 13.08.2019, pas kësaj date aplikacionet e dorëzura nuk do të merren në konsideratë

per: 
Zenel Bunjaku
Drejtore Ekzekutive

